



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim A-B

Ngarkesa: 3 kredite, 30 orë seminari

Viti / Semestri: Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master shkencor në “Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs synon t’u mprehë studentëve shikimin përsa u përket vështirësive që hasen në përkthimin e teksteve të zhanreve të ndryshme (politike, shoqërore, kulturore, turistike, filologjike, etj.), me qëllim që ata të jenë të aftë që pas një analize të mirëfilltë shumëplanëshe (pragmatike, leksikore dhe terminologjike, gramatikore dhe stilistikore) të zhvillojnë strategji në nivel mikro dhe makro për të sintetizuar tekstin në gjuhën mbërritëse, duke njohur karakteristikat specifike të këtyre teksteve.

Objektivat specifike dhe rezultatet e të nxënit:

Në përfundim të kursit studentët do jenë të aftë t’u përgjigjen sfidave që parashtrojnë përkthimi i teksteve të sipërpërmendura për kombinimin gjuhesor A-B. Ata do të dinë të përdorin hap pas hapi instrumentet e duhura në të përditshmen profesionale.

Rezultatet të pritshme:

Kjo është një lëndë e detyrueshme dhe synon t’u japë studentëve njohuri bazë mbi termat e përdorura në tekstet paraletrare të gjuheve A dhe B si edhe t’i aftësojë ata në përkthimin e këtyre teksteve. Lënda synon t’i nxitë studentët të kryejnë punë kërkimore dhe terminologjike duke punuar me dokumenta origjinalë, fjalorë terminologjikë, enciklopedi, si edhe me internetin.